



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr. _____ Prot.

Datë _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Nafte për nevojat Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Skrapar për vitin 2025”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09134000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 9 780 111 (nëntë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike , Çorovodë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter është vendosur që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë ose autorizim të ushtrimit të aktivitetit (Tregtim me pakicë karburantesh) të lëshuar nga Njësia Vendore, sipas pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 20, të Ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

(shënim- përcaktoni, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, llojin e licencës së nevojshme që lidhet me objektin e prokurimit, si dhe institucionin që lëshon licencën e kërkuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenet 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Për të provuar përshtatshmërinë për ushtrimin e veprimtarinë profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Gjithashtu kjo kërkesë është bazuar dhe në Ligjin Nr.8450 dt. 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar , si dhe në VKM nr. 970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Kriteri i vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesit e mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me licencat profesionale, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara në legjislacionin e sipërpërmendur.

Ky kriter lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që prokurohet .

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Raport-Analizimi për tregun e brendëshëm, për cilësinë e karburantit, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) duhet të jetë lëshuar përgjatë vitit fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; nenit 40 pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe ligjit Nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mund të dorëzojnë dëshmi për rezultate e testime zyrtare, të lëshuara

nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike

Fletë analiza e karburantit është një dokument i rëndësishëm, pasi dokumenton cilësinë e karburantit të tregtuar nga OE. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të karburanteve të tregtuara. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për ofrimin e karburantit cilësor.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj duke përmbushur edhe specifikimet teknike është kërkuar që të paraqitet Raport analizimi për cilësinë e karburantit, lëshuar nga organi përkatës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se dispononin të paktën një pikë shitje/furnizimi të mallit brenda territorit të Bashkisë Skrapar , e pasqyruar kjo tek të dhënat në QKB dhe e pasqyruar me Niptet (Adresat) Sekondare, shoqëruar me Cerftifikatë Pronësie ose Kontratë Qeraje.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë një pikë të furnizimit me karburant në pronësi ose qira/ kontratë bashkëpunimi, brenda territorit të Bashkisë Skrapar.

Ky kriter është vendosur për të provuar disponueshmërinë e pikës së karburantit nga operatori ekonomik dhe për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, nëse operatori shpallet fitues. Përcaktimi i vendndodhjes brenda territorit të Bashkisë Skrapar është vendosur për të bërë të mundur furnizimin e vazhdueshëm dhe periodik të mjeteve të institucionit pa kosto ekstra në karburant.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë në bazë të së cilës merr përsipër furnizimin me karburante sipas standarteve në fuqi.
- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në të gjitha pikat e tij brenda territorit të Bashkisë Skrapar, me kartë elektronike të personalizuar me targën e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor (për të provuar këtë pikë kandidati duhet të paraqesi deklaratën nga administratori i subjektit ofertues).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 dhe 5, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë realizimin me sukses të kontratës si dhe kërkesës së Autoritetit Kontraktor që shërbimi nga ana e Operatori Ekonomik të mbulohet për 24 orë.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë certifikatatë **ISO 9001:2015** “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalentin e saj.

Shënim: Çertifikata e mësiperme/ekuivalente duhet të jetë e lëshuar nga Institucione të çertifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombëtare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këto certifikata në përputhje me shërbimet që ka marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mallrat, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë.

Kërkesa për certifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente të akredituar nga një organ i njohur ndërkombëtar, synon të garantojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë sistemet e duhura të menaxhimit të cilësisë. Kjo certifikatë tregon se operatorët ekonomikë kanë kapacitetet e nevojshme për të ofruar produkte me cilësi të lartë, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Kjo kërkesë për certifikatë të akredituar synon të garantojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë aftësitë e duhura për të përmbushur me sukses kërkesat e kontratës. Në thelb, argumentimi teknik mbështet vendosjen e këtij kriteri si një mënyrë për të siguruar cilësinë dhe standardet e larta të produktit që do të ofrohen në kuadër të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Të dhënat teknike të Gazoil (blu-dizel 10 ppm) i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH): Karburant dizel (Gazoil) sipas S SH EN 590:2022 ose ekuivalent

Nr	Emërtimi	Njësia	Kufijtë e lejuar		Metoda e provës
			Min	Max	
1	Numri cetanit		51	-	EN ISO 5165
2	Indeks i cetanit		46.0	-	EN ISO 4264
3	Densiteti ne 15 C	kg/m3	820	845	EN ISO 3675 EN ISO 12185

4	Hidrokarbure policiklik aromatik	% (m/m)	-	8.0	EN 12916
5	Permbajtja e squfurit	mg/kg	-	10.0	EN ISO 20846 EN ISO 20847 EN ISO 20884
6	Pika e flakerimit	oC	oC Mbi 55	-	EN ISO 2719
7	Mbetje karbon	% (m/m)	-	0.30	EN ISO 10370
8	Permbajtja e hirit	% (m/m)	-	0.01	EN ISO 6245
9	Prembajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
10	Ndotja e pergjithshme	mg/kg	-	24	EN 12662
11	Korrozioni il shufres se bakrit (3 ore ne 50 ⁰ C)	Vleresuar	Klasa 1		EN ISO 2160
12	Stabiliteti i oksidimit	g/m3	-	25	EN ISO 12205
13	Vetitë lubrifikuese, diametri i korrektuar i njollës së gripuar (gërryer) (ësd 1,4) në 60 °C	µm	-	460	EN ISO 12156-1
14	Viskoziteti ne 40 oC	mm2/s	2.00	4.50	EN ISO 3104
15	Destilimi				EN ISO 3405
	% (VN) ne 250 °C	% (VN)		0<65	
	% (VN) ne 350 °C	% (VN)	85		
	95 % (VN)	oC		360	

Çmimet për njësi janë marrë nga bursa “PLLATS” e datës 23. 01.2025

të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të publikuara në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 05 .Datë 27.01.2025 .

NJËSIA E PROKURIMIT